



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**  
**Seksioni i Administratës**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr. Prot.**  
**Nr. Dok. 201601865/10**

**Tiranë** \_\_\_/\_\_\_/2017

**Lënda:** *Rekomandohet ushtrimi kontrollit për çështjen e shtetases R.S., në ZVRPP, Fier, lidhur me zbatimin e legjislacionit në fuqi.*

**Drejtuar :** **Kryeregjistruesit të Zyrës Qendrore të Rregjistrimit Pasurive të Paluajtshme**  
Z.Ilirian Muho

**Për dijani :** **Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Drejtësisë,**

**TIRANE**

**Zj. R.S.**  
Adresa :

**FIER**

Z.Kryeregjistrues!

Në procesin e shqyrtimit të ankesës së shtetases R.S., në të cilën është prezantuar shkelja e së drejtës të pronësisë, Institucioni i Avokatit të Popullit, konsideron, se, qëndrimi që është mbajtur dhe mbahet prej ZVRPP, Fier, është i parregullt, dhe në cënim të parimit të ligjshmërisë, mbrojtjes së interes publik dhe të drejtave të personave private, drejtësisë dhe paanësisë, përgjegjshmërisë, sikurse parashikuar në nenin 9, 10, 12 dhe 14 të Kodit të Procedurës Administrative dhe të detyrueshëm në kuptim dhe zbatim të nenit 1 të këtij Kodi.

Çështja për të cilën ankuesi ka kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit, qëndron si më poshtë prezantuar.

Në cilësinë e bashkëpronarit mbi pasurinë objekt njohje në pronësi sipas Vendimit nr. 155, datë 15.08.1995, të Komitetit Kthimit dhe Kompesimit të Pronave ish Pronarëve, Bashkia, Fier, korrigjuar me Vendimin nr.39, datë 22.05.2007, të Agjencisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, Zyra Rajonale e Qarkut, Fier, me objekt;

*"1. Të njoh të ndjerin X.B. si ish-pronar mbi një sipërfaqe trualli prej 16.250m2, ndodhur në Lagjen "Afrim i Ri".*

*2. T'ju kthej zotërinjve K.X.B., D.X.P(B.), Th.X.B., për pjesën e K.X.B., M.K.B., S..K.B. M.K..B, Dh.K. , për pjesën e Th.X.B., zotërinjtë Dh.Ll.B., V.Th.B., D.TB., V. T.B., M. Th.B.,*

*R.Th.B. dhe trashëgimtarë të pjesës së M.K.B., janë V.Z.B., J.M.B., Ll.V.B., një sipërfaqe trualli prej 6647m<sup>2</sup> e ndarë në parcelat sim ë poshtë;*

*Parcela e parë me sipërfaqe prej 975m<sup>2</sup> e ndodhur në Afrim të Ri, lagje e qytetit, me kufizime nga veriu –vendstrehim, jugu rrugë fshati, Lindje prone e të zot dhe shtëpi, perëndimi shtëpi banimi e K.K..*

*Parcela e dytë me sipërfaqe prej 1566m<sup>2</sup> e ndodhur në Afrim të Ri, lagje qytetit, Fier, sot kufizohet nga veriu rrugë fshati, nga jugu shtëpi banimi e K.K., lindje prana e të zot dhe perëndimi prone e të zot dhe vendstrehim.*

*Parcela e tretë me sipërfaqe prej 3612m<sup>2</sup> e ndodhur në Afrim i Ri, lagje e qytetit Fier, dhe kufizohet nga V-rrugë fshati, J-rrugë fshati, L-shtëpia e Ll.D., P- shtëpi prone e të zot dhe M.B. dhe I.Sh.*

*Parcela e katërt me sipërfaqe prej 494m<sup>2</sup> e ndodhur në lagjen Afrim I Ri, sot lagje e qytetit Fier, dhe kufizohet nga V-shtëpia e M.B., J-shtëpia e Ll.D. L-rrugë e fshtait, P- pronë e të zot*

*3. Të kompesoj zotërinjtë e cituar në pikën dy të vendimit për sipërfaqen prej 9603m<sup>2</sup>.*

*4. Një kopje e këtij vendimi i çohet zyrës së hipotekës, Fier, për hipotekimin e pikës dy të vendimit bashkëngjitur me planvendosjen”.*

Bazuar në titullin e pronësisë si më lartpërmendur, Zyra e Hipotekës, Fier, sot ZVRPP, Fier, ka regjistruar atë në rregjistrin hipotekor me nr.1033, datë 09.10.1995, duke lëshuar me këtë rast dhe Notën e Transkriptimit në favor të bashkëpronarëve.

Përkundër situatës së lartpërmendur, ankuesja ka kërkuar (aplikimet 3825, datë 23.05.2013, dhe nr.9375, Datë 03.10.2013), mundësimin e pajisjes së saj me aktet e pronësisë për pasurinë e lartpërmendur, (çertifikatë “Për vërtetim pronësie, hartë treguese si dhe kartelë pasurie) por ZVRPP, Fier, nuk ka bërë të mundur lëshimin e tyre me pretendimin se; Vendimi nr.155, datë 15.08.1995, i KKKP, Bashkia, Fier, nuk është konfirmuar prej Agjensisë së Trajtimit të Pronës. Kjo Agjensi në përgjigje të konfirmimit të kërkuar prej ZVRPP, Fier, me shkresën nr. 661/1 prot, datë 21.03.2016, informon se :

*“Nga verifikimet e kryera pranë arkivës së AKKP-së, Tiranë, rezulton se, dosja që i përket Vendimit nr.155, datë 15.08.1995, të ish-KKKP-së, Bashkia, Fier, në emër të subjektit X.B., nuk ndodhet e depozituar në arkivin e institucionit tonë”.*

Ndodhur në këtë situatë, ZVRPP, Fier, nuk ka proceduar dhe nuk procedon për lëshimin e dokumenteve të pronësisë në favor të trashëgimtarëve të të ndjerit X.B., për sipërfaqen 6647m<sup>2</sup> të njohur në pronësi me të drejtë kthimi në natyrë, sipas Vendimit nr.155, datë 15.08.1995, të KKKP, Bashkia, Fier. Qëndrimin e shprehur prej ZVRPP, Fier, duke kushtëzuar lëshimin e dokumenteve të pronësisë në favor të trashëgimtarëve të të ndjerit X.B., për sipërfaqen 6647m<sup>2</sup> të njohur në pronësi me të drejtë kthimi në natyrë, sipas Vendimit nr.155, datë 15.08.1995, të KKKP, Bashkia, Fier, nuk e vlerësojmë të rregullt. Në kushtet kur ZVRPP, Fier, ka të administruar titullin e pronësisë original, Vendimin nr.155, datë 15.08.1995, të KKKP, Bashkia, Fier, të korrigjuar, plan rilevimet e dorëzuara prej trashëgimtarëve të të ndjerit X.B., për sipërfaqen e tokës 6647m<sup>2</sup> të njohur në pronësi

me të drejtë kthimi në natyrë, ndarë në katër parcela, aplikimet e kryera për marrjen e dokumentacionit të pronësisë për cilëndo parcelë të sipërfaqes prej 6647m<sup>2</sup>, gjykojmë se nuk ekziston shkak ligjor i cili justifikon moslëshimin e dokumeneteve të pronësisë në favor të trashëgimtarëve të të ndjerit X.B..

Në këtë situatë, qëndrimi i mbajtur prej ZVRPP, Fier, në vlerësimin tonë është parregullt, e në shkelje të detyrave funksionale për punonjës in i cili ka pasur dhe ka detyrimin për kryerjen e veprimeve për zgjidhjen e kësaj situatë.

Në kushtet kur ZVRPP, Fier, nuk ka përmbushur detyrimin sikurse kërkuar prej ankuesit, në afatin e përcaktuar në aplikimet e kryera, gjykojmë se, qëndrimi i ZVRPP, Fier, vjen në kundërshtim me parimet e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, si ai i ligjshmërisë, mbrojtjes së interesit publik dhe të të drejtave të personave privat, drejtësisë dhe paanësisë, të detyrueshme për zbatim në kuptim dhe zbatim të nenit 1 të këtij Kodi. Për arsyet e bëra me dije në këtë shkresë, Institucioni i Avokatit të Popullit bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohet se : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe nenit 21/b, se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”.

## REKOMANDOJMË

*Ushtrimi kontrollit për çështjen e shtetasit R.S., në ZVRPP, Fier, lidhur me zbatimin e legjisllacionit në fuqi.*

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

*Bashkëlidhur ju dërgojmë:*

*Kopje të Kërkesës, aplikimit nr.3825, datë 14.05.2013, të kryer prej V.B.*  
*Kopje të Kërkesës, aplikimit nr.3826, datë 14.05.2013, të kryer prej V.B.*  
*Kopje të Kërkesës, aplikimit nr.3811, datë 14.05.2013, të kryer prej V.B.*  
*Kopje të Kërkesës, aplikimit nr.3810, datë 14.05.2013, të kryer prej V.B.*  
*Kopje të Kërkesës, aplikimit nr.3828, datë 14.05.2013, të kryer prej V.B.*  
*Kopje të Kërkesës, aplikimit nr.3829, datë 14.05.2013, të kryer prej V.B.*  
*Kopje të Kërkesës, aplikimit nr.18592, datë 18.11.2015, të kryer prej R.S.*  
*Kopje të Kërkesës, aplikimit nr.10918, datë 17.11.2014, të kryer prej V.B.*  
*Kopje të Kërkesës, aplikimit nr.9375, datë 03.10.2013, të kryer prej V.B.*  
*Kopje të Kërkesës, aplikimit nr.10918, datë 17.11.2014, të kryer prej V.B.*  
*Kopje të Kërkesës, aplikimit nr.3827, datë 14.05.2013, të kryer prej V.B.*  
*Kopje të Kërkesës, aplikimit nr.3812, datë 14.05.2013, të kryer prej V.B.*  
*Kopje të Kërkesës, aplikimit nr.3814, datë 14.05.2013, të kryer prej V.B.*  
*Kopje të Kërkesës, aplikimit nr.3815, datë 14.05.2013, të kryer prej V.B.*  
*Kopje të Kërkesës, aplikimit nr.3816, datë 14.05.2013, të kryer prej V.B.*  
*Kopje të Kërkesës, aplikimit nr.3817, datë 14.05.2013, të kryer prej VB.*  
*Kopje të Kërkesës, aplikimit nr.3818, datë 14.05.2013, të kryer prej VB.*

*Kopje të Kërkesës, aplikimit nr.3819, datë 14.05.2013, të kryer prej VB.*  
*Kopje të Kërkesës, aplikimit nr.3820, datë 14.05.2013, të kryer prej VB.*  
*Kopje të Kërkesës, aplikimit nr.3821, datë 14.05.2013, të kryer prej VB.*  
*Kopje të Kërkesës, aplikimit nr.3822, datë 14.05.2013, të kryer prej VB.*  
*Kopje të Kërkesës, aplikimit nr.3823, datë 14.05.2013, të kryer prej VB.*  
*Kopje të Kërkesës, aplikimit nr.3824, datë 14.05.2013, të kryer prej VB.*  
*Shkresë nr.s'ka, datë 03.07.2014, e ZVRPP, Fier, drejtuar RS.*  
*së bashku me hartën treguese për sipërfaqen 6647m2 e ndarë në katër parcela.*  
*Kopje të aplikimit datë 21.05.2001, i kryer prej VB..*  
*Kopje të aplikimit datë 28.12.2011, i kryer prej VB.*  
*Mandat arkëtimi nr.3597 datë 21.05.2001 i ZVRPP, Fier.*  
*Mandat arkëtimi nr.72 datë 09.03.2007 i ZVRPP, Fier.*  
*Mandat arkëtimi nr.86 datë 02.04.2007 i ZVRPP, Fier.*  
*Mandat arkëtimi nr.1383 datë 28.12.2011 i ZVRPP, Fier.*  
*Kopje të shkresës nr.9982 prot, datë 09.01.2016, të ZVRPP, Fier, drejtuar ZQRPP, Tiranë.*  
*Kopje të shkresës nr.8610 Prot, datë 10.11.2016, të ZVRPP, Fier, drejtuar Avokatit të Popullit.*  
*Kopje të shkresës nr.661/1 Prot, datë 21.03.2016 të AKKP, Tiranë, drejtuar R.S.*

**KOMISIONERI**

**Etilda GJONAJ(SALIU)**

**Konceptoi dhe Daktilografoi**  
**A.Gjoleka**